

VENDIM
Nr. 474, datë 22.5.2013

**PËR NGRITJEN E MEMORIALIT “USHTARËT AMERIKANË TË RËNË NË LUFTË”, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e memorialit “Ushtarët amerikanë të rënë në luftë”, në Republikën e Shqipërisë.
 2. Bashkia e Tiranës të caktojë një vend të përshtatshëm për ngritjen e memorialit “Ushtarët amerikanë të rënë në luftë”.
 3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrin masat e duhura për ngritjen e një grupi të përbashkët pune, i cili të kryesohet nga Zëvendësministri i Mbrojtjes, me qëllim studimin dhe vlerësimin e formës, përmasave dhe modelit të këtij memoriali.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha